

EVALDA PACI**LETËRSIA E VJETËR SHQIPE SI OBJEKT VËZHGIMESH
NDËRDISIPLINORE: VLERA E VEÇANTI SHKRIMTARIE
NDËR AUTORË DHE VEPRRA**

Ekzistenca e një traditë solide studimesh dhe gjurmimesh mbi letërsinë e vjetër shqipe dhe autorët kryesorë që e përfaqësojnë atë, dëshmon rëndësinë që kjo periudhë kohore, që kapërcen dy shekuj, vijon të ketë për studimet shqiptare dhe disiplina të veçanta të tyre. Janë studiuar prej kohësh tekste themelore të këtyre veprave, aspekte të individualitetit të autorëve që ndërmorën të përpilonin të tilla vepra, çështje të ndikimit të secilit prej modeleve të kohës apo dhe prej kulturave që kanë pasur rol në formimin e tyre. Nuk mungojnë studime mbi çështje të autorësisë në lidhje me disa vepra të kësaj letërsie, ndërkohë që nga ana e historianëve të mesjetës së vonë shqiptare janë kryer dhe hulumtime të natyrës arkivore mbi dokumentacionin që hedh dritë mbi rrethanat e realizimit të veprave të saj si dhe me biografinë e vetë autorëve të sipërpërmendur. Përbën një periudhë e tillë një prej harqeve kohore më të rëndësishme për historinë e shkrimit shqip dhe letërsinë e shkruar shqipe.

Veprat e letërsisë së vjetër shqipe kanë gëzuar vëmendjen e të qenit objekt vëzhgimesh të disa disiplinave: shtysë e këtij fakti ka qenë kureshtja dhe nevoja e gjurmimit më të thelluar të periudhës kohore që shënon realizimin e botimeve të caktuara apo dhe të dokumenteve fragmentare që gjithsesi mbeten dëshmi të rëndësishme që ndihmojnë të hidhet dritë në studime të mirëfillta mbi vetë brendinë e veprave dhe më tej dhe në rrethanat konkrete që lidhen me përvijimin e gjithsecilës.

Vëzhgimet e kryera kanë gjithashtu një histori të vetën në pikëpamje të hapave të ndërmarra, iniciativave që u bënë shkas të gjurmoheshin konkretisht ekzemplarë dhe ksombla veprash apo doracakësh doktrinarë që përfaqësojnë njëkohësisht objektet kryesore të interesit për historianin, bibliofilin, filologun e teksteve, gjuhëtarin, por dhe studiuesit e elementeve metrike e prozodike që përmbahen në pjesë të caktuara të këtyre veprave.

Të flasësh për natyrën tekstologjike të secilës prej veprave të letërsisë së vjetër shqipe do të thotë gjithashtu dhe të konsiderosh objektivisht elemente qenësore të përmbajtjes, ndërtimit, konceptimit, shfaqjes së modeleve tekstore në pjesë kyçe të tyre, arritshmërinë e shkrimtarisë në autorë të caktuar, mungesën e vjegëzave që do të ndihmonin patjetër në ndriçimin e mjaft detajeve që duke u njohur konkretisht do të plotësonin natyrshëm një kuadër që

përpilohet sa herë duhet të flitet për një vepër, një ekzemplar libror, një model përmbajtësor që në rastin e veprave të letërsisë së vjetër shqipe ofron një hapësirë të konsiderueshme diskutimi dhe reflektimi.

Studimet e kryera mbi këto vepra nuk kanë qenë vetëm të natyrës gjuhësore apo të përqendruara në nënsisteme specifike që kanë të bëjnë me aspekte fonologjike e morfologjike të gjurmueshme në gjuhën e tyre, me çështje të formimit të fjalëve apo me kategori të caktuara kryesisht gramatikore. Të tilla studime sigurisht përfaqësojnë arritje mjaft të mira në pikëpamje të shtjellimit të elementeve të rëndësishme të tekstit dhe të metatekstit në përmbajtjen e këtyre veprave; dialektologjia historike do të vilte gjithashtu të dhëna me vlerë pikërisht nga gjurmimi i lemave dhe i trajtave që reflektohen natyrshëm në sytë e këtyre veprave e kjo falë dhe faktit që natyrshmëria në të shkruar e autorëve të kësaj letërsie pasqyron dhe gjendje konkrete në përdorime dhe ndërtime që i interesojnë leksikologut dhe dialektologut, por sigurisht dhe filologut e gjurmuesit të teksteve të vjetra shqipe.

Natyrshmëria e sipërcituar është faktor i rëndësishëm dhe për të shtruar një tjetër pistë vëzhgimi e më tej dhe interpretimi të domosdoshëm: shkrimtaria dhe autorësia si kompetenca që nuk duhen ndarë nga njëra-tjetra kur flitet për këto vepra, për variantet përkatëse kur për ndonjërin është realizuar dhe ribotimi, për çështje të referencialitetit tekstor dhe të modeleve të adaptuara nga autorët e kësaj letërsie.

Pavarësisht paracaktimit përkatës të secilës prej veprave të sipërcituara, gjurmimi i vlerave që kanë të bëjnë me estetikën dhe me thelbin e letrarësisë ka qenë më se i mundur dhe njëkohësisht ka vënë në dukje aspekte aspak rastësore apo periferike në pikëpamje të brendësimit përmbajtësor të tyre.

Brendësimi përmbajtësor mbetet një fushë e gjerë vëzhgimi që të orienton nga zbulimi i mjaft dimensioneve që ngërthehen në përmbajtjen e këtyre veprave. Lejon një orientim i tillë të ngulmohet në elemente dhe pjesë të caktuara, që në përmbajtje të një libri orësh, zbulojnë ndikimin nga modele gjegjëse e që patjetër duhet të jenë marrë parasysh ndërkohë që përgatitej një vepër e asaj natyre; ekzistenca e varianteve me modifikime të ndjeshme në pjesë të ndryshme të së njëjtës vepër apo dhe nga autori në autor është gjithashtu një linjë që zbulon qoftë pasurinë e disponimit të teksteve të tilla në vepra dhe autorë, qoftë faktin që modifikimet në të tilla elemente bëjnë që këto vepra të mbartin dhe përmasa të një origjinaliteti të qartë tekstor.

Duke u përfaqësuar nga vepra të ndryshme në pikëpamje ndërtimi dhe natyre tekstologjike, letërsia e vjetër shqipe ofron përherë dhe në mënyrë të pashtershme një mozaik vlerash dhe arritjesh dhe në pikëpamje shkrimtarie e personaliteti të autorëve përfaqësues të saj.

Falë realizimit të tyre sot e kësaj dite disponojmë variante interesante psalmesh, me një mundësi të qartë referimi ndaj atyre gjegjëse në libra e

psalterë të kohës që lidhen me zhvillime të rëndësishme në historinë e Kishës së Romës dhe çështje të revizionimit të teksteve themelore biblike; konsultojmë në gjuhën tonë një model kompleks libror që përmban në vijimësi elemente të Offices, Breviarit, Ritualit e Mesharit. Ungjijtë dhe Veprat e apostujve pasqyrohen në dimensione fragmentare, por gjithsesi mjaftueshëm për të kryer qasje dhe reflektime mbi shqipërimin, përputhshmërinë përmbajtësore dhe çka është më me rëndësi: kompetencën e autorit në pikëpamje të përmbushjes së këtyre parametrave të rëndësishëm në studimin tekstologjik të veprave të kësaj natyre. Edhe në përpjekje për të realizuar krahasime të mundshme me variante që mund të rezultojnë jo të afërta në kohë me këto vepra të marra në shqyrtim, mund të vihet jo rrallë në dukje që pikërisht në pikëpamje të realizimit të përçimit të një mesazhi të domosdoshëm në të tilla tekste, letrarësia dhe gjurmimi i fjalës më të përshtatshme në pikëpamje domethënieje dhe përputhshmërie me tekstin në fjalë mbeten prirjet mbizotëruese tek studiuesit e kësaj fushe.

Mund të thuhet me plot gojën se me veprat e letërsisë së vjetër shqipe lidhet ideja e fillesave të shkrimtarisë në gjuhën tonë. Me gjithë veçantinë e qartë që secila prej veprave të kësaj periudhe mbart në vetvete për arsye të inicimit specifik dhe të destinimit po aq të përcaktuar, tipare jorastësore spikasin në çdo rast analize përmbajtësore dhe formale.

Pothuaj në lidhje me secilën prej tyre mund të veçojmë vlerësime që kanë të bëjnë me performimin në të shkruar, përshtatjen tekstore si metodë pune si dhe me vetë brendinë e pjesëve të caktuara, të konsideruara universale për vetë faktin se bartin shembëlltura të mirënjohura në historinë e shkrimit të shenjtë.¹

Rimarrja e tyre dhe në variante të përshtatura në formate vjershërimi, nënvizimi i një mesazhi të qartë biblik që përbën nëntekstin e episodeve të caktuara nga librat e Shkrimit të Shenjtë; përpjekja jo aq e lehtë për të sjellë në versione të shqipëruara psalmet biblike; evokimet e rimarra të përmbajtura në Litanitë e Shenjtërve; integrimi i pasazheve koncize ndërkohë që shtjellohen nocione dogmatike e koncepte të kanonit; tipare të tjera që mund të dalin në pah ndërkohë që analizohet në veçanti secila prej këtyre veprave, janë elemente që mbështesin konsiderimin e mësipërm e që qe dhe iniciativa e ndërmarrjes së kësaj trajtese nga ana jonë.

Krahasimet e mundshme në pikëpamje përftesash dhe ndërtimesh, sidomos kur mund të gjurmohen motive të ngjashme në pjesë të caktuara të tyre, ndihmojnë të vënë në dukje dhe individualitetin e secilit prej autorëve të

¹ Pothuaj te të gjithë autorët e kësaj letërsie është e mundur të gjurmohet çështja e shqipërimit të tekstit biblik në gjuhën shqipe. Mbeten pararojë në këtë drejtim autorë si Gjon Buzuku dhe Pjetër Bogdani, pa lënë mënjanë as të njëjtën prirje në pjesë të caktuara të veprave të shqipëruara nga Pjetër Budi apo në fragmente që janë risjellë në Doktrinën e vitit 1743 nga Gjon Nikollë Kazazi.

kësaj letërsie, dhe autonominë e mundshme në pikëpamje të përzgjedhjes së elementeve të tekstit dhe të shprehësisë. Autorëve të caktuar të kësaj letërsie tradita e gjurmimeve mbi këtë periudhë u njeh dhe risi e përrurime elementesh të veçanta në disa pikëpamje.

Shtjellimet e përmasave aspak modeste në veprën *Cuneus prophetarum* (Patavii, 1685) të Pjetër Bogdanit, përdorimet që nuk ndeshen në autorë paraardhës të tij, vetë natyra e veprës që ai ndërmoi bashkë me sprovën e vënies përballë të dy gjuhëve të ndryshme nga njëra-tjetra e për më tepër me një histori të ndryshme në pikëpamje të promovimit të shkrimit, fleksibiliteti në përzgjedhje e përdorime fjalësh që i përkasin së njëjtës familje apo hyjnë në të njëjtën sferë semantike, e bëjnë objekt të një interesi të gjallë studimin përmbajtësor dhe thellimin në metatekstin e mjaft pjesëve të vetë veprës së tij. Teksti biblik vijon të jetë instrument i rëndësishëm dhe në penën dhe mendjen e këtij shkrimtari, por në një perspektivë të ndryshme nga ç'duhet të shërbejë në një doracak kateketik apo në një libër orësh dhe lutjesh të liturgjisë.

Ky fakt nuk mënjanon aspak koncizitetin në pasqyrimin e elementit tekstor biblik dhe referencialitetin e qartë që ndryshe nga ç'mund të vëzhgohet apo deduktohet në autorë si Buzuku dhe Budi, gjurmohet në tekstin në krah të variantit të sjellë nga autori në gjuhën shqipe.

Gjurmohet kësisoj dhe teksti në gjuhën latine që për më tepër autori e ka sjellë dhe në gjuhën shqipe njësoj si pjesët e tjera që i takojnë shtjellimit ezegjetik dhe teozofik nga ana e tij. Kjo vepër mund të emërtohet e vështirë, komplekse, e pasur, e thellë në argumente, interesante dhe tërheqëse dhe në pikëpamje të distancës kohore që ndan momentin kur kjo e fundit ka parë për herë të parë dritën e shtypit. Kjo vepër vijon të vlerësohet për merita të pasqyrimin në të të mjaft nocioneve dhe njohurive nga shumë fusha të dijes, të cilat autori i bën të vetat, por dhe i reflekton me vetëdije në pasazhe të përcaktuara të saj.²

Dhe pse jo rrallë është paraqitur mendimi që autorët e kësaj periudhe të zhvillimit të shkrimit shqip mund të kenë pasur mundësinë të konsultojnë përpilime të paraardhësve, një fakt i tillë nuk pengon të nënvizojmë që individualiteti i secilit shtjellohet në mënyrë diskrete dhe kjo vihet re qartë dhe në diversitetin gjuhësor që ndër të tjera mbështetet dhe nga faktorë qenësorë siç janë formimi dhe prejardhja konkrete e secilit.

Sa herë janë kryer vëzhgime të hollësishme mbi vepra të caktuara të kësaj periudhe dhe veçanërisht mbi faktin e përmbajtjes së teksteve të tyre ndaj burimeve referenciale të cilat mbartnin dhe aprovimin nga hierarkia kishtarë e

² U shtojmë konsideratave të mësipërme faktin që vetë autori e pasuroi veprën në hyrje të saj me modele poetike të një vlere të konsiderueshme për nga shkalla e arritjes dhe modelit tekstor që evokojnë, duke na u ofruar ndër të tjera dhe në gjuhët e kulturës së kohës.

kohës, është nënvizuar dhe ideja e një prirjeje që mund ta quajmë personalizim në drejtim të përpilimit të tekstit, fakt ky më se i qartë sidomos në rastin e shqyrtimit të varianteve doktrinare e kateketike të përshtatura e të përgatitura prej Pjetër Budit.

Gjurmues të teksteve të vjetra shqipe që kanë ndërmarrë dhe konsiderimin e disa dimensioneve të pranishme në përmbajtjen e tyre kanë veçuar gjithashtu dhe për efekt studimi një përzgjedhje aspak të rastësishme nga këto shqipërime, duke bërë të konsiderohen tashmë si një korpus tekstor që përçon veçori të rëndësishme dhe qenësore të shkrimtarisë së këtij të fundit³.

Studimi i shfaqjes së aspekteve të shkrimtarisë për autorë të veçantë si Pjetër Budi e Pjetër Bogdani përbën në të vërtetë një prej perspektivave më interesante në fushë të vëzhgimeve ndërdisiplinore që ofron vetë letërsia e vjetër shqipe, duke qenë me interes të konsiderueshëm si në pikëpamje periodizimi dhe kronologjizimi, ashtu dhe në atë të kontekstualizimit në një kuadër që duhet të marrë parasysh me çdo kusht rrethanat historike e politike që kapërcejnë kufijtë e realitetit shqiptar të kohës. Kjo linjë nga ana tjetër ndihmon të nënvizohet me të drejtë fakti që ndërmarrja e veprave të ndryshme nga natyra dhe përmbajtja, pavarësisht elementeve tematike të përbashkëta që vetëkuptohen në këtë rasë ka bërë që pikërisht te këta autorë të gjurmohen shfaqje të individualitetit dhe veçantisë intelektuale, gjithashtu dhe të genuinitetit që nuk i gjen në të tjera vepra të përafërta në kohë. Me ta shtrohet një rrugë e sigurt në pikëpamje të lëvrimin të një regjistri specifik gjuhësor, por dhe në atë të konsolidimit të përdorimeve që një proces të tillë do ta përurojnë pikësëpari në të tilla vepra.

Për t'iu kthyer sërish reflektimit të çështjes së konsiderimit të shkrimtarisë dhe prirjeve për të sjellë në format vjershërimi motive dhe elemente qenësore biblike në veprat e këtyre autorëve, pikërisht Pjetër Budi do të mbetet një nga më të cituarit dhe më të ndërmendurit, dhe sidomos për faktin që pasqyrohen në përbërje të veprave të përpiluara prej tij krijime të natyrës himnodike, por dhe didaktike që paraqesin dhe orientime vetjake të këtij të fundit për personalizim të tekstit dhe të vetë përmbajtjes së veprës. Mbetet ky argument burim diskutimesh të gjera që nuk humbasin aktualitetin në ditët e sotme, aq më tepër nëse reflektohet për vlera shkrimtarie dhe për objektiva të qarta në këtë drejtim nga ana e autorit të varianteve që panë dritën e botimit kryesisht në vitet 1618-1621, periudhë kjo në të cilën dhe nga vetë dëshmitë e këtij autori del e qartë që jo vetëm përgatitja për botim, por dhe sigurimi i një approbatur-i mbetet një arritje e vështirë për këdo që ndërmerre të tilla prova.

³ Shih në veçanti R. Ismajli, *Pjetër Budi: Poezi*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2006, në të cilën përbahen mjaft pjesë të përzgjedhura nga krijimtaria dhe nga përpilimet e këtij autori të letërsisë së vjetër shqipe.

Për ta përforcuar një linjë të tillë me arritje konkrete do të thoshim se *Pjetër Budi*, *vjershëtor* mbetet një prej argumenteve më të dashura e të trajtuara hollësisht prej Henrik Lacajt, klasikistit të mirënjohur që pasqyroi dhe në sprovat studimore kushtuar këtij autori njohuritë e vyera në fushë të studimit të prozodisë dhe metrikës klasike. Janë shënimet e këtij studiuesi që ndërgegjësojnë mirëfilli sa e rëndësishme është të reflektohet objektivisht dhe në drejtim të këtij dimensionit kaq të qartë ndërkohë në gjithë veprën e tij, pasqyruar me një numër të konsiderueshëm vargjesh sa të natyrshme në të përpiluar, aq dhe të kujdesuara prej tij.⁴ Janë pikërisht pjesë të tilla që zgjuan kërshtërinë për krahasime nga ana e studiuesve që i janë kushtuar veprës së këtij autori, dhe që mund të bëhen objekt qasjesh me elemente himnodike klasike të letërsisë së krishterë, në veçanti të asaj të instrumentalizuar në krijime muzikore të njohura.

Të tilla motive i lejuan dhe autorit tonë të shprehej natyrshëm dhe me nota shpirtërore mbi motive që kanë jetuar gjatë në kohë, po aq gjatë sa dhe tradita e krishtëritimit në botë. Në veprat e tij gjurmohet figuracioni dhe në karakterizimin e personazheve të rëndësishme të cilave u kushtohen dhe pasazhe nga më të kujdesuarat.

Për ta lidhur një fakt të tillë me veprën e sipërpërmendur të Pjetër Bogdanit, ky i fundit dhe në përputhje me natyrën e veprës së vet i segmenton të tilla ndarje dhe në përpjesëtim me gjithë shtrirjen tematike të saj, duke realizuar trajtesa të përmasave të lavdërueshme në shumë pikëpamje, gjithashtu dhe në atë të përafrimit të figurave biblike me anë mjetesh si gjuha dhe stili. Figurave dhe motiveve të caktuara të Bogdani u kushtohen ligjëratat të mirëfillta, ndërkohë që vetë autori investon mjete e elemente tekstore për t'i dhënë secilit vendin e duhur⁵.

Mbetet një argument i tillë objekt vëmendjeje dhe për trajtesa më të zgjeruara që duhet të kenë në konsideratë dhe analiza konkrete tekstore nga veprat e sipërcituara. Hulumtimi tekstologjik ndihmon qartë dhe pastër dhe në pikëpamje të sqarimit të mjaft çështjeve që mund të shtrohen mbi brendinë e veprave të letërsisë së vjetër shqipe dhe jo më pak dhe në trajtimin më të thelluar të çështjes së shkrimtarisë dhe të individualitetit intelektual të secilit prej autorëve të kësaj letërsie.

⁴ H. Lacaj, *Pjetër Budi, vjershëtor i parë i letërsisë sonë*, në “Studime filologjike”, nr. 4, 1966, f. 151-158.

⁵ Për të tilla analiza dhe përshkrime shih në veçanti pjesën e dytë të veprës së Pjetër Bogdanit (1685) në P. Bogdani, *Cuneus prophetarum (Çeta e profetëve)*, botim kritik përgatitur nga A. Omari, Tiranë, 2005.

BIBLIOGRAFI

- Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhë shqipe I*, Shkodër, 1996.
- Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe II*, Tiranë, 1998.
- Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe III*, Tiranë, 2000.
- Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe IV*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2002.
- Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe V*, Shkodër, 2009.
- Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe VI*, Shkodër, 2012.
- Bogdani, P., *Cuneus prophetarum (Çeta e profetëve)*, botim kritik përgatitur nga A. Omari, Tiranë, 2005.
- Budi, P., *Rituale Romanum et Speculum confessionis in Epyroticam linguam a Petro Budi Episcopo Sapatense et Sardanense translata*, Romae, 1621.
- Budi, P., *Dottrina Christiana, composta per ordine della fel.mem. di Papa Clemente VIII*, Roma, 1664.
- Budi, P., *Dottrina Christiana(1618), with a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane*, Institut for Lingvistik, Aarhus, 1985.
- Budi, P., *Poezi, (Parathënia, tejskrimi dhe komentet: R. Ismajli)*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Bulo, J., *Le «Missel» de Gjon Buzuku entre la Reforme et la Contre-Reforme*, në “Studia Albanica”, 2006.
- Camaj, M., *Il “Messale” di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, “Shêjzat”, Romë, 1960.
- Camaj, M., *Pjetër Budi (në rasën e katërqindvjetorit të lindjes)*, në “Shêjzat”, nr. 9-12, 1966.
- Çabej, E., *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kriteret rreth botimit të tyre*, në BUSHT, nr. 2, 1959.
- Çabej, E., *Vepra e Gjon Buzukut në vështrim historik e gjuhësor*, në “Studime filologjike”, nr. 1, 1979.
- Çabej, E., *Studime shqiptare, Vepra të zgjedhura*, ASHAK, Prishtinë, 2008.
- Demiraj, B., *Viti i zbulimit të Mesharit të Gjon Buzukut dhe ndonjë çështje që lidhet me të*, në “Biblos”, Palermo, 2003.
- Ismajli, R., *Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipes*, në “Gjurmime Albanologjike”, Prishtinë, 1978.
- Ismajli, R., *Gramatika e parë e gjuhës shqipe*, në “Studime filologjike”, nr. 4, 1980.
- Ismajli, R., *Gramatika e parë e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1982.
- Ismajli, R., *Gjuha shqipe e “Kuvendit të Arbënit”*, Rilindja, Prishtinë, 1985.
- Ismajli, R., *Artikuj për gjuhën shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1987.
- Ismajli, R., *Kontributi i Martin Camajt në studimet buzukiane*, në ““Meshari” i Gjon Buzukut-monument i kulturës shqiptare (1555-1995)”, Ulqin, 1995.

- Ismajli, R., *Tekste të vjetra, Botime Dukagjini, Pejë, 2000.*
- Ismajli, R., *Studime për Buzukun në vitet '50 të shekullit XX*, në “Studime filologjike”, nr. 3-4, 2005.
- Ismajli, R., *Les études sur Buzuku aux années '50 du XX-ème siècle*, në “Studia Albanica”, 2006.
- Lacaj, H., *Pjetër Budi, vjershëtor i parë i letërsisë sonë*, në “Studime filologjike”, nr. 4, 1966.
- Marlekaj, L., *Doli libri më i vjetri i gjuhës shqipe*, në “Shëjzat”, nr. 1-2, 1959.
- Ismajli, R., *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2015.
- Marlekaj, L., O.F.M., *Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo*, Liantonio editore, Palo del Colle, Bari, 1989.
- Omari, A., *Disa risi në fushën e botimit të teksteve të vjetra shqipe*, në Konferenca shkencore: “Çështje të studimeve diakronike të shqipes”, ASHAK, 2009.
- Omari, A., *Veçori të punës filologjike të Selman Rizës me tekstet e vjetra shqipe*, në “Studime filologjike”, nr. 1-2, 2010.
- Paci, E., *Meshari i Gjon Buzukut në studimet e Martin Camajit*, në “Hylli i Dritës”, nr. 4, 2010.
- Paci, E., *Letërsia e vjetër shqipe në kontekstin e historisë së letërsisë shqiptare*, në “Hylli i Dritës”, nr. 2, 2011.
- Paci, E., *Kolofoni në Mesharin e Gjon Buzukut*, në “Hylli i Dritës”, nr.1, 2012.
- Paci, E., *Çështje të leksikut liturgjik në veprën e Pjetër Bogdanit*, në “Studime për nder të Rexhep Ismajlit me rastin e 65-vjetorit të lindjes”, Botime Koha, Prishtinë, 2012.
- Paci, E., *Studime mbi tekstet e vjetra shqipe*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2017.
- Ressuli, N., *Il “Messale” di Giovanni Buzuku, riproduzione e trascrizione*, Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958.
- Ressuli, N., *I più antichi testi albanesi*, G. Giappichelli, Torino, 1978.
- Ressuli, N., *Shkrimtarët shqiptarë I (1462- 1878), Botim II*, Pakti, Tiranë, 2007.
- Riza, S., *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1961.
- Riza, S., *Vetësia dhe veprat e Pjetër Budit*, në “Gjurmime albanologjike”, Seria e Shkencave filologjike, VIII, Prishtinë, 1978.
- Riza, S., *Vepra I*, ASHAK, Prishtinë, 1996.
- Riza, S., *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, Toena, Tiranë, 2002.
- Riza, S., *Vepra IV*, ASHAK, Prishtinë, 2004.
- Roques, M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, L.O.P.Geuthner, Paris, 1932.

- Sciambra, M., *Bogdanica (studi su Bogdani e l'opera sua), volume II, saggio sul lessico scientifico e culturale del Bogdani*, Pàtron editore, Bologna, 1965.
- Sedaj, E., *Bibla e përkthimet e saj në gjuhën shqipe*, Shtufi, Prishtinë, 1999.
- Sedaj, E., *Shqipja arbërore*, Prishtinë, 2002.
- Svane, G., *How to read Budi's Speculum confessionis*, në "Studia Albanica", nr. 1, 1980.
- Svane, G., *The formation of the literary language as reflected in Budi's «Mirror of Confession» 1621*, në "Studia Albanica", nr. 2, 1985.
- Svane, G., *Formimi i gjuhës letrare të «Speculum Confessionis» e Budit*, në "Studime filologjike", nr. 2, 1986.
- Zamputi, I., *Shënime mbi kohën dhe jetën e Pjetër Bogdanit*, në "Buletin për Shkencat Shoqërore", nr. 3, 1954.
- Zamputi, I., *Ricerche su Pjetër Bogdani*, në "Rassegna di studi albanesi", Roma, nr. 1, 1964.
- Zamputi, I., *Koha dhe veprimtaria e Pjetër Budit*, në "Nëndori", nr. 9, 1966.
- Zamputi, I., *Qëmtime për Budin e Bardhin*, në "Studime historike", nr. 1, 1985.
- Zamputi, I., *Mbi rrethanat historike të botimit të "Mesharit" të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqiptare*, në "Studime filologjike", nr. 3, 1986.
- Zamputi, I., *Les circonstances historiques de la parution du "Missel" de Gjon Buzuku et sa place dans la littérature albanaise*, në "Studia Albanica", nr. 1, 1988.
- Zamputi, I., *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe*, në "Hylli i Dritës", nr. 1-2, 1995.

SUMMARY

OLD ALBANIAN LITERATURE AS AN OBJECT OF INTERDISCIPLINARY OBSERVATION: VALUES AND PECULIARITIES AMONG AUTHORS AND WORKS

The existence of a solid tradition of studies and researches on the old Albanian literature and the main authors that represent it proves the importance that this period of time beyond two centuries continues to have for Albanian studies and their particular disciplines. The fundamental texts of these works have been studied so far, the aspects of the authors' individuality that have devised such works, issues of an influence of each of the models of the time, and of cultures that have played a role in their formation. There are also studies

on authorship issues related to some works of this literature, while historians of the Albanian late Middle Ages have carried out archival research on the documentation that sheds light on the circumstances of the realization of its works as well as the biography of the aforementioned authors. This period is one of the most important timeframes for the history of Albanian writing and written Albanian literature.